

Nr. 135617 /7 Prot

Tiranë, më 02.05.2023

Lënda : Dërgohet – Shpallje Ankandi të Parë Për Shitje Sendi Të Paluajtshëm

Drejtuar : Bashkia Maliq

Bashkëngjitur kësaj shkrese Ju dërgojmë dokumentin me Nr. 135617 /5 Prot, Datë 02.05.2023 për shpalljen e ankandit të parë për shitjen e sendit të paluajtshëm, i përpiluar nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat.

Duke qenë në dijeni se pranë çdo Bashkie funksionon Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, apo Sektori i Informimit Qytetar, si edhe masat dhe përgatitjen që bën ky sektor për bërjen publike të informacioneve të ndryshme që vihen në dispozicion të publikut, pa kërkesë.

Ju dërgojmë këtë shpallje për t'a afishuar në ambientet e përcaktuara të Bashkisë, të cilat janë të disponueshme dhe shërbejnë për të njëjtat qëllime informuese.


Referuar nenit 568 të K.Pr.Civile, kërkojmë nga ana Juaj që të krijohen kushtet e duhura për publikimin dhe mbarëvajtjen e kësaj shpalljeje për një periudhë 15 - ditore.

Ju Faleminderit për bashkëpunimin!

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Rigels BEJKO



Nr. 46 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 135617 /5 Prot

Tiranë, më 02.05.2023

SHPALLJE

(PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKAND)

Unë, Rigels Bejko, me detyrën Përmbarues Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.(11-2017-1415)391datë 24.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore, kërkesën e kreditorit Institucioni financiar Micro Credit Albania shpk, zgjedhur te perfaqesohet ne rruge gjyqesore dhe/ose jashtegjyqesisht nga subjekti juridik ADCA shpk me NIUS K92012006Q, E-Mail:info@adca.al; Tel:+355 682097137, ndaj debitorit Arben (Edmond) Pandi Velo dtl 24/01/1971 (Ad: L.17 RR.K.KAZANXHI DURRES) në lidhje me titullin ekzekutiv “Kontrate per hua afatmesme Nr.4614/3730 date 13.03.2006”.

Me përmbushjen konform ligjit të të gjithë hapave të parashikuara dhe të kërkuara procedurale, si edhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, parashikuar në nenin 567 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA

Se pala debitore nuk i është përgjigjur në asnjë rast detyrimit që mbart kundrejt kreditorit, si edhe të gjitha njoftimeve të cilat i janë bërë me dije nga përmbaruesi gjyqësor.

Lidhur sa më sipër, referuar neneve 568 dhe 570 te Kodit të Procedurës Civile, si edhe Ligjit Nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, bëj këtë

SHPALLJE

Për shitjen ne ankand të sendit të paluajtshëm, si më poshtë treguar:

Pasuria : Kodi Unik 2445001061, Apartament, me Nr.pasurie 89/88+2-11, Zk.2445, Vol.1, Fq.61, me Sip.total 73 m2, indeksi hartes KO-LIBO-55, Libonik, Maliq, Korce

E cila është në pronësi te Arben (Edmond) Pandi Velo.

➤ Me këtë shpallje njoftoj të gjithë të interesuarit, duke i

INFORMUAR SE

a) Çmimi i sendit të paluajtshëm që shitet ka vlerën si më poshtë treguar:

Pasuria : Kodi Unik 2445001061, Apartament, me Nr.pasurie 89/88+2-11,Zk.2445,Vol.1,Fq.61, me Sip.total 73 m2, indeksi hartes KO-LIBO-55, Libonik, Maliq,Korce

➤ Ne vleren 1,695,936.0 (nje milion e gjashteqind e nentehjete e pese mije e nenteqind e tridhijete e gjashte)Leke

b) Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendit është salla e mbledhjeve të Zyrës se Permbarimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k. e cila gjendet në adresën: BULEVARDI “GJERGJ FISHTA” KULLA NR. 5, KATI I 11-TË, NR.54 TIRANË

c) Ankandi për shitjen e sendit të paluajtshëm shpallet sot dhe do të qëndrojë i publikuar deri më datë 18.05.2023.

d) Dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrjen në ankand do të pranohen në të gjithë afatin 15 - ditor dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të ankandit do të kryhet në datën **18.05.2023**, duke u mbyllur në orën 16.00 me mbarimin e orarit zyrtar.

e) Secili ofertues duhet të depozitojë bashke me kërkesën për pjesëmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të çmimit fillestar në llogarinë e Vecantë bankare.

KJO SHPALLJE AFISHOHET NË: Bashkinë Maliq, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, Adresën e sendit të paluajtshëm që shitet në Maliq, Korce. Në dy gazeta kombëtare për 5 ditë me radhë dhe Zyrën e Përmbarimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “TDR GROUP” sh.p.k.
PËRMBARUES GJYQËSORË

Rigels BEJKO